



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:242237
Datë: 14.05.2024
Numri i dokumentit: 05683132

Ac.nr.3373/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Naim Mehollu, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.A, të cilin e përfaqëson me autorizim avokati Sh.I, kundër të paditurave Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimi Rural dhe Agjensionit për Ushqim dhe Veterinë që i përfaqëson Avokatura Shtetërore, për kompensim të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj C.nr.9/2019 e datës 22.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 13.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurës Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe zhvillimit Rural, me seli në Prishtinë dhe VËRTETOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj C.nr.9/19 e datës 22.02.2021.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin ankimor C.nr.9/19 e datës 22.02.2021, ka vendosur si vijon:

APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit H.A.

DETYROHET e paditura Agjensia e Veterinës dhe Ushqimit me seli në Prishtinë që paditësit H.A në emër të demit të pësuar në katër (4) shoqëritë e Bletëve nga sëmundja “Pesta Amerikane” t’i kompenzojë dëmin në shumën prej 480 euro me kamatën në normën prej 8% nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, si dhe shpenzimet e procedurës për hartim të padisë shumën prej 105 euro, 20 euro taksë për padi, për ekspertizë shumën prej 150 euro, si dhe për 3 përfaqësime të avokatit nga 135 euro shumën prej 405 euro të gjitha në afatin prej 15 dite nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit.

REFUZOHET kërkesëpadia ndaj të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në mungesë të legjitimacionit pasiv.

Refuzohet pjesa e kërkesëpadisë si e pabazuar në shumën prej 1,200 euro.

Kundër këtij aktgjykimi, e autorizuar e të paditurave në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe aktgjykimi ankimor të priset dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur i autorizuari i paditësit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 lidhur me nenin 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi H.A, përmes të autorizuarit të tij, pranë gjykatës së shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimi Rural dhe Agjensionit për Ushqim dhe Veterinë që i përfaqëson Avokatura Shtetërore, për kompensim dëmi, me kërkesë të përshkruar si në dispozitivin e aktgjyimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilën e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke arsyetuar se inspektimin në bletishtën e paditësit nga komisioni profesional është vlerësuar se paditësi ka pësuar dëm në dy shoqëri të bletëve ndërsa me ekspertizën e ekspertit të bletarisë, faktet të cilat i ka të mbështetura në përvojën profesionale është vërtetuar lartësia e dëmit në shumë prej 480.00 euro. Mbi bazën e kësaj gjendje faktike gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktgjyimit të atakuar, duke u bazuar në nenin 136.1 dhe nenin 382 të LMD-së dhe nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit i pathemeltë qëndron pretendimi ankimor i palës ankuese për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të paraparë me nenin 182 par.2 pika n) të LPK-së, ngase aktgjykimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjyimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjyimit. Në arsyetim të aktgjyimit po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjyimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjykata e Apelit nuk i ka pranuar pretendimet e të paditurës për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë sepse e paditura e dytë e

ka konstatuar fakti se 2 shoqëri të bletëve të paditësit janë infektuar me sëmundjen ngjitëse të rrezikshme, Pesta Amerikane, të cilat shoqëri janë asgjësuar si dhe janë vlerësuar në shumë prej 200 euro, ndërsa nga ekspertiza e ekspertit të bletarisë Mr.sc.H.D, është vërtetuar fakti vendimtar se me datën 11/05/2018 janë asgjësuar shoqëria e bletëve nr.8 dhe 14, kurse me datën 25/05/2018, janë asgjësuar edhe bletët nr.3 dhe 5 dhe dëmi i shkaktuar nga asgjësimi i bletëve është në shumë prej 480.00 euro, ndërsa e paditura e dytë me asnjë provë materiale nuk ka arritur të vërtetoj të kundërtën e asaj që e ka konstatuar ekspertiza gjyqësore si dhe gjatë shqyrtimit kryesor nuk ka propozuar ekspertizë tjetër nga fusha e bletarisë. Sipas nenit 7.1 të LPK-së është paraparë: *Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*, ndërsa neni 319.1 të po këtij ligji ka paraparë: *Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta* ndërsa neni 322.3 i po këtij ligji ka paraparë: *Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër.*

Nga një gjendje e tillë faktike e konstatuar dhe vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, i pathemeltë qëndron pretendimi ankimor i të paditurës edhe sa i përket zbatimit të gabuar të ligjit material, për arsye se baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësit, gjënë mbështetje në nenin 136 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 10 Maj 2012, i cili ka hyrë në fuqi nga data 20 Dhjetor 2012, e cila dispozitë përcakton se: “ Kush i shkaktonte tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij ”, ndërsa neni 24.3 të Ligjit për Bletari parasheh: Kompensimi i dëmeve për asgjësimin e bletëve rregullohet me dispozitat e Ligjit për veterinarinë, gjegjësisht sipas nenit 8 të Rregullores Për Vlerësimin dhe Kompensimin e Fermerëve për Kafshët e Asgjësuar si pasojë e sëmundjeve Infektive Ref.Auv.01-086/20 parashihet: Pronarit të bletëve i takon kompensimi i demit për bletët e asgjësuar, të vërtetuar nga sëmundja nga neni 3 par.1 nen par.1.5 të kësaj rregullore. Në kuptim të këtyre dispozitave rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadisë.

I drejtë del te jetë edhe vendimi për shpenzimet e procedurës, pasi që shpenzimet e njohura janë në përputhje të plotë me shpenzimet që i njëjti i ka pasur rreth përfaqësimit të paditurve në procedurë dhe kanë qenë të nevojshme për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, që do të ndikonte në ligjshmërinë e aktgjykimit, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.3373/21, me datë 13.05.2024

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku